



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60//01-11129/21
Kaçanik, 23.04.2021

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IV-të (Katërt)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VI e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 23.04.2021. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në Zyrën e Kryetarit të Komunës, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përberja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve sa ka KPF, pjesëmarrës në mbledhje ishin të 7 anëtarët: Kemal Mërseli, Nexhat Loku, Pranverë Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, Selim Reka, Hafize Sallahi dhe Rabije Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës – Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale, Bahri Selimi, Ramadush Osmani dhe Ukshin Qallaku.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, prezentë në mbledhje janë 7 anëtarë-të gjithë, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e IV-të (Katërt) të Rregullt të KPF-a për vitin 2021, data 23.04.2021, me këtë

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës së vitit 2021;
3. Propozim Vendimi për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021;
4. Propozim Vendimi për subvencionimin e operatorëve të transportit publik të udhëtarëve të Komunës së Kaçanikut dhe NPK “Stacioni i Autobusëve” Kaçanik;
5. Propozim Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në parcelat kadastrale (listuar si në tabelë) në ZK Kaçanik, për projektin: Vazhdimi i rrugës “Ismail Raka” – segmenti nga shtëpia e kulturës “Xheladin Kurtaj” deri të “Xhamia e Dëshmorëve” në Kaçanik;
6. Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për katërdhjetë (40) vite, PK Nr. 70917003-01580-0 në sipërfaqe 23.379m² ZK Begracë, PSH – Kullosë e klasës së

3, personit juridik, JLG Constructions SH.P.K NUI; 811498642 me pronar Agron Zeneli, me procedurë të negociimit të ofertës; dhe

7. Propozim Vendimi për ndarjen e parcelës kadastrale Nr. 649-0, ZK Kaçanik, P. SH Shtëpia e Shëndetit, për ndërtimin e Shtëpisë Integruese.

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 7 pikëve.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së III-të (Tretë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë: 15.03.2021 /Lënda: 01Nr. 60/01-7667/21.

2. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës së vitit 2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, para se me hapur diskutimin, fjalën e ka drejtori i DEFZH, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, Si çdo vit që ngelin mjete buxhetore të pashpenzuara, edhe në këtë vit kemi mbetje të mjeteve buxhetore të pashpenzuara të cilat mjete duhet bartur për shpenzim në këtë vit. Buxheti i Komunës së Kaçanikut për këtë vit është diku 8.7 milion, Mjetet e pashpenzuara janë në 506,352.72€, me çka buxheti rritet nga ai i miratuar, në shumë: 9,288.951.72€. Mjetet janë shpërndarë në këtë mënyrë; Për Mallra dhe Shërbime shuma prej 20,000.00 euro Subvencione dhe Transfere shuma prej 32,705.40 euro, Investime Kapitale shuma prej 453,647.32 euro. Në pjesën në tabela janë paraqitur se nga kanë ngelur mjetet, orientimin e tyre së ku do të shpenzohen. Ky proces është i rregullt i bartjes së mjeteve, këto mjete duhet shpenzohen sivjet, dhe krejt këto mjete shkojnë në ngritje të mirëqenës së qytetarëve.

Kryesuesi i Kuvendit, Lidhur me këtë pikë, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Mua me intereson, përse nuk janë shpenzuar mjetet e vitit 2019, ndërkaq për ato të vitit 2020 e kuptoj se kanë pasur mundësi të ngelin mjete buxhetore të pashpenzuara, të cilat mjete duhet bartur për shpenzim në vitin 2021. Për mjetet e arsimit të cilat kanë ngelur pa shpenzuar, ndërkaq dihen nevojat e arsimit, duke filluar nga Gjimnazi "Skënderbeu" dhe shkollat tjera, me intereson të di, përse nuk janë shpenzuar këto mjete. Nevojat janë që Gjimnazi dhe shkollat tjera të pajiset me projektor statik, e që besoj se kjo pajisje ndikon në cilësinë e arsimit. Nevojë tjetër e kësaj shkolle është edhe oborri i shkollës dhe shkallët. Nëse dikush vjen e viziton këtë shkollë, në bien një hije jo e mirë e gjendjes së oborrit dhe shkallëve të saj. Unë kisha kërkuar që të shikohet mundësia që mjeteve që janë ndarë për arsim, t'u shtohen ende mjete dhe me u kryer

këto punë, përndryshe është mirë që pjesa dërmuese e mjeteve po shkojnë për investime kapitale, e mos t'na ndodhë si vitin e kaluar që pjesa dërmuese të mjeteve u orientuan për Covid-19.

z. Bahri Selimi, Të kërkesa e parë, mjetet zakonisht mbesin edhe këto që po barten, ka mundësi që përsëri disa të mbesin, munden me u bartë nga viti në vit, sepse ne me tepër po insistojmë të shpenzojmë grantin qeveritar, kështu po ngelin mjete nga HVK. Shuma nuk është e madhe e mjeteve të vitit 2019, shumica e mjeteve janë mbetje të subvencioneve nga aktivitetet kulturore e sportive. Pasi bëhen bashkë mjetet e ngelura në vitin 2021 me një kod 22 dhe nuk përmenden më që janë të dy viteve. Më mirë është më i ruajtur mjetet e mbetura, sesa me i shpenzuar vend e pavend. Të pyetje e dytë, me tepër është kompetent drejtori i DAK.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni të pajtimit që kjo pikë t'i shkoj Kuvendit të Komunës në procedurë të shqyrtimit dhe aprovim? Rezultati i votimit është njëzëri Për. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF, e

Aprovoj

Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës së vitit 2021; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3. Propozim Vendimi për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, në Propozim Vendim janë paraqitur mjetet që do të transferohen në programe të caktuara buxhetore. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë Propozim Vendim e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2021; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Vendimi për subvencionimin e operatorëve të transportit publik të udhëtarëve të Komunës së Kaçanikut dhe NPK "Stacioni i Autobusëve" Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit, Të kjo pikë kisha dashur me shtuar diçka, ndoshta ka qenë mirë me u plotësuar ky Propozim Vendim për mënyrën sesi kanë më u ndarë këto subvencione. A kanë me u ndarë sipas numrit të autobusëve që kanë kompanitë apo në formë të barabartë. Për mbledhje të kuvendit është mirë me u definuar kjo punë, sepse nuk është njëjtë sikur me pasur 1 autobus apo 1 kombi-bus në raport me kompaninë e cila i ka 7 apo 8 autobus. Është mirë me u caktuar njëfarë kriteri, që mos me pasur dilema në KK për këtë çështje.

z. Ramadush Osmani- drejtor i DSHPE, Propozim Vendimi është bërë në bazë të kërkesës së operatorëve. 7 operatorë janë me autobus dhe 3 operatorë janë me kombi-bus. Përfaqësuesit e kompanive janë pajtuar për ndarje të barabartë, pavarësisht prej numrit të autobusëve që ka kompania. Njëjtë ka vepruar edhe Ferizaj për operatorë e jo për numër të autobusëve. Ferizaj ua ka ndarë ka 4 mijë euro për operator, edhe ne mendojmë një ndarje të barabartë për secilin operator nuk do të krijonte pakënaqësi të operatorëve. Ata janë të pajtimit që secili operator që e ka lejen, me u subvencionuar njëjtë. Nëse kalojmë me kategorizime, mund të lindin kërkesa ekstra. Ne, këtë variant ua sjellim në KK për me diskutuar.

Kryesuesi i Kuvendit, Unë nuk e shoh të arsyeshme që një operator me një autobus me u subvencionuar në formë të barabartë me operatorin që ka 7 autobusë, siç është operatori “Beka” apo operatori “Mani”.

znj. Rabije Sallahu, Pyetje për drejtorin e DSHPE, A keni biseduar vetëm me një operator apo me të gjithë operatorët për çështjen e subvencionimit të tyre ? Ndoshta ka qenë mirë me mbajt një mbledhje me krejt operatorët e kompanive dhe me diskutuar këtë çështje.

z. Ramadush Osmani, Subvencionet janë nga Zyra e Kryetarit të Komunës. Ne mundemi me caktuar kriterin dhe u pajtuan apo nuk u pajtuan operatorët, por nganjëherë duke dashur me subvencionuar, nuk po duam me krijuar pakënaqësi të operatorëve.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Vet përfaqësuesi i kompanisë “Mani” ka ardhur me këtë propozim, për mos me pasur probleme me kompanitë tjera. Ai ka qenë vetë këtu të unë dhe e ka dhënë këtë propozim, ky ishte opinioni i të gjitha kompanive të autobusëve.

z. Ramadush Osmani, Shuma e ndarë e mjeteve për subvencionim është 15.000€ (pesëmbëdhjetëmijë euro,) Përfaqësuesi i kompanisë “Mani” ka propozuar të jetë ndarje e barabartë për operatorët me autobus dhe ndarje e barabartë për operatorët me kombi-bus. Është edhe varianti tjetër me rende të udhëtimit, por rendet e udhëtimit dallojnë njëra nga tjetra.

z. Ekrem Kyçyku, E kam një pyetje, A do të subvencionohen edhe taksitë, sepse edhe taksitë ka kohë që kanë punuar me kapacitete të kufizuara për shkak të Covid-19.

Kryesuesi i Kuvendit, Taksitë nuk janë ndalur, kanë punuar vazhdimisht, nëse i ka pasur 3 persona për Ferizaj, pagesën e ka marrë sa e ka çmimin me qenë i mbushur taksi.

Kryetari i Komunës, Taksitë kanë punuar vazhdimisht, ndërkaq autobusët një kohë nuk kanë punuar fare.

z. Selim Reka, Mirë është që po subvencionohen këto kompani, ndërkaq është mirë të shqyrtohet mundësia e subvencionimit edhe të; sallave të dasmave, sepse sallat e dasmave janë dëmtuar që dy vite me së shumti në kohën e pandemisë.

Kryetari i Komunës, Sa i përket sallave të dasmave, kemi menduar me i liruar nga tatimi në pronë në kohën e pandemisë. Kjo është një ndihmë që mund t’ua ofrojmë, restoranteve dhe sallave të dasmave.

z. Bahri Selimi, Buxheti është simbolik, nëse qeveria ndan mjete për subvencionim të Covid-19, atëherë bisedojmë bashkë për orientimin e tyre. Sa i përket sallave të dasmave, kemi menduar me i liruar nga TP në kohën e pandemisë, së me iu dhënë mjete nuk mundem, mundem vetëm me iu krijuar lehtësira.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky Propozim Vendim t’i shkoj KK në procedurë për shqyrtim dhe aprovim ? Për ishin të gjithë, kështu që konstatohet së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për subvencionimin e operatorëve të transportit publik të udhëtarëve të Komunës së Kaçanikut dhe NPK “Stacioni i Autobusëve” Kaçanik; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Propozim Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në parcelat kadastrale (listuar si në tabelë) në ZK Kaçanik, për projektin: Vazhdimi i rrugës “Ismail Raka” – segmenti nga shtëpia e kulturës “Xheladin Kurtaj” deri të “Xhamia e Dëshmorëve” në Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit, Lidhur me këtë pikë, drejtori është prezent në mbledhje, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, A keni biseduar me pronarët e këtyre parcelave dhe a keni marrë pëlqimin e tyre për shpronësimin e pronave në fjalë.

z. Ukshin Qallaku, Nuk kemi biseduar me pronarët e pronave, sepse nuk e kemi obligim me biseduar kur shpallet një pronë interes i përgjithshëm publik. Ndërtimi i rrugës është më interes strategjik, është problem me biseduar me pronarët, ndërkaq të njoftuar janë shumica nga pronarët. Pronarët kanë ardhur këtu në komunë, janë interesuar dhe nuk ka pasur ndonjë reagim nga ta, ndërkaq përpos dy pronarëve, ndërtimi i kësaj rruge bëhet mirë edhe për ta. Ndërtimi i rrugës është më interes të përgjithshëm publik. Kjo rrugë është një ndër rrugët me të rëndësishme të komunës dhe duhet zgjeruar ajo pjesë me qarkulluar dhe me u lidhë me Gërlicë. Qytetarët nëse mendojnë me zgjeruar pjesën urbane, me ndërtimin e kësaj rruge, krijohen mundësitë, ndërkaq sesa do të paguhet shpronësimi i pronave vendosë ministria. Vlerësimi që është bërë për Rekë, ka qenë i vogël, ndërkaq këtu vlerësimi besoj se do të jetë më i madh. Ne po e shpallim interes të përgjithshëm publik ato prona, mundemi edhe marrëveshje me bërë me banorët, mirëpo pikë e parë është me u shpallë interes i përgjithshëm publik ato prona.

z. Selim Reka, Realizimi i këtij projekti është i mirë, sepse i jep mundësi zhvillimit të qytetit. Pyetja ime është; A preket ndonjë shtëpi me këtë shpronësim, nëse po, kush e paguan shpronësimin?

z. Ukshin Qallaku, Procesi i kompensimit zgjatë 2 vite, ne nuk e dimë, sa kanë me u vlerësuar shpronësimet, kjo çështje ka procedura, por fillimisht ne po e nisim këtë procedurë.

znj. Hafize Sallahi, A është paraparë shuma e mjeteve për këto shpronësime të pronave ?

z. Ukshin Qallaku, Jo, nuk është paraparë shuma e mjeteve, sepse nuk kemi të drejtë me planifikuar, pa ndodhë shpronësimi.

z. Bahri Selimi, Janë vlerësimet e licencuara sesa shkon çmimi i tregut të pronave në fjalë. Ne duhet me planifikuar buxhetin për 2 vjet për realizimin e shpronësimeve të pronave në fjalë.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky Propozim Vendim t’i shkoj KK në procedurë për shqyrtim dhe aprovim ? Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Nga kjo del konstatimi që, KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në parcelat kadastrale (listuar si në tabelë) në ZK Kaçanik, për projektin: Vazhdimi i rrugës “Ismail Raka” – segmenti nga shtëpia e kulturës “Xheladin Kurtaj” deri të “Xhamia e Dëshmorëve” në Kaçanik; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për katërdhjetë (40) vite, PK Nr. 70917003-01580-0 në sipërfaqe 23.379m² ZK Begracë, PSH – Kullosë e klasës së 3, personit juridik, JLG Constructions SH.P.K NUI; 811498642 me pronar Agron Zeneli, me procedurë të negocimi të ofertës;

Kryesuesi i Kuvendit, Në bazë të ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, Kryetarit të Komunës i jepet e drejta për me negociuar ofertë për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim. Fjalën e ka Kryetari i Komunës, Besim Ilazi për sqarime të nevojshme.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Njoftoj për ofertën e negociuar me personin juridik, JLG Constructions SH.P.K NUI; 811498642 me pronar Agron Zeneli, prona me Nr. 01580-0 në sipërfaqe 23.379m² ZK Begracë, PSH -kullosë e klasës së 3, investimet që do të bëhen, numri i punëtorëve që do të punësohen, etj. Lënda do të vjen në KK, ju vendosni. Për shkak të zgjedhjeve lokale, nuk na lejohet me udhëhequr procedurat me anë të komisionit vlerësues.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjuat sqarimet e kryetarit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Si ofertë, mua me është dukur e mirë. Ishte një shumë e madhe e mjeteve që kishte planifikuar firma me investuar, plus numri i punëtorëve të cilët do të punësohen në atë firmë. Është afati dinamik i përcaktuar i realizimi të projektit, çështje kjo të cilën ne duhet ta kemi parasysh.

z. Ekrem Kyçyku, Sa ka komuna tokë në pronësi të saj me dhënë në shfrytëzim ? Unë e pash numrin e punëtorë (deri në 70 punëtorë) që planifikon kompania t'i punësoj në atë firmë. Mendimi im është që, komuna duhet ruajtur tokën për me dhënë në shfrytëzim kompanive të forta investuese, sepse toka nuk shtohet, ndërkaq në të ardhmen mund të kemi ndonjë kompani të fortë që është e interesuar me investuar. Nga lënda shihet së toka që jepet në shfrytëzim është në sipërfaqe të madhe, mbi 2 hektarë, ndërkaq numri i të punësuarve është i vogël. Ne duhet pasur orientim zhvillimin e komunës duke dhënë në shfrytëzim sipërfaqe të vogla të pronës komunale, ndërkaq numri i punëtorëve me qenë i madh, si; ndërtimi i ndonjë fabrike rrobaqepësie e cila mund të përfshijë 100 punëtorë. Këtë metodë e aplikon Shqipëria. Ne në këtë formë e ruajmë pronën komunale në njërin anë, ndërkaq në anën tjetër punësohet një numër i madh i punëtorëve.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky Propozim Vendim t'i shkoj KK në procedurë për shqyrtim dhe aprovim ? Për ishin të gjithë, kështu që konstatohet së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për katërdhjetë (40) vite, PK Nr. 70917003-01580-0 në sipërfaqe 23.379m² ZK Begracë, PSH – Kullosë e klasës së 3, personit juridik, JLG Constructions SH.P.K NUI; 811498642 me pronar Agron Zeneli, me procedurë të negocimi të ofertës; dhe e njëjta i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

7. Propozim Vendimi për ndarjen e parcelës kadastrale Nr. 649-0, ZK Kaçanik, P. SH Shtëpia e Shëndetit, për ndërtimin e Shtëpisë Integruese;

Kryesuesi i Kuvendit, Para se me hapur diskutimin, fjalën e ka drejtori i DUKMM, Ukshin Qallaku;

z. Ukshin Qallaku- drejtor i DUKMM, Është një kërkesë për ndërtimin e një shtëpie rehabilituese për persona me të meta psikike, ndërkaq sa është zgjidhje kjo për ta, unë nuk e di. Ne kemi propozuar lokacione të tjera me larg qendrës, por nuk lejohet, sepse kjo shtëpi me rregulla të nivelit qendror, ishte e paraparë të ndërtohen afër qendrës.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Me pas qenë drejtoresha e DSHMS e kishte sqaruar më mirë, së është ma në rrjedha. Shtëpia rehabilituese e cila do të ndërtohet, sa e di unë, nuk është vetëm qëndrim ditor, aty personat e tillë flenë, qëndrojnë, mbjellin dredhëza, përgatisin ushqim etj.

z. Ekrem Kyçyku, Është një projekt i mirë ky, ndërkaq nuk e di se a mund të jetë më larg qendrës ndërtimi i këtij objekti, përndryshe si projekt është shumë i mirë, vetëm së problemi është së, mos është shumë afër shkollës ndërtimi i këtij objekti.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky Propozim Vendim t'i shkoj KK në procedurë për shqyrtim dhe aprovim ? Për ishin të gjithë anëtarët e KPF, kështu që konstatohet së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për ndarjen e parcelës kadastrale Nr. 649-0, ZK Kaçanik, P. SH Shtëpia e Shëndetit, për ndërtimin e Shtëpisë Integruese ; dhe i njëjti i ,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Kryesuesi i Kuvendit, Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora: 11:48 Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët sa ishin në mbledhje.

Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 29 Prill 2021 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu
Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli
Kemal Mërseli

